



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 849/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nenad Laziç kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Magdalena Kqira – Kandidate për Asamble Komunale, për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjakovë paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhorë (KQZ), për shkak të keqpërdorimit dhe pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 13.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Hidhet** si e pas afatshme ankesa e Magdalena Kqira – Kandidate për Asamble Komunale, për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjakovë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Magdalena Kqira – Kandidate për Asamble Komunale, për subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Gjakovë, me datë 12.11.2013, në ora 15:30 në të cilën ka pretenduar se, gjatë numërimit mu janë keqpërdorur votat në vendvotimet e caktuara : Bishtazhin – 0208C, Brekoc – 0222C, Doblbare – 0224C, Shkolla Fillore “Zekrija Rexha”, Gjakovë, 0205C, Gjinnazi “Hajdar Dushi”, Gjakovë – 0201C, Shkolla Fillore ”Yll Morina”, Gjakovë – 0202X, Shkolla Fillore “Mustafa Bakrija, Gjakovë,- 0202C, Shkolla Fillore “Kadri Kusari”,Gjakovë -0204/C, “Ganimete Tërbeshi”, Piskot – 0223C. Për më tepër ka shtuar se, kërkoj që ankesa ime të shqyrtohet dhe të rinumërohen votat e humbura.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

### **ankesa është e pas afatshme**

Me ankesën e parashtuar nga Magdalena Kqira – Kandidate për Asamble Komunale PDK dega në Gjakovë ka pretenduar se, gjatë numërimit mu janë keqpërdorur votat e mija në vendvotimet e lartcekura.

PZAP-i pasi shqyrtoi ankesën konstatoi se, ankesa është e pas afatshme pasi që, nga shkelja e supozuar ankesa nuk është dorëzuar në afatin e rregullt ligjorë deri më datë 04.11.2013, që nënkupton se e njëjta është dorëzuar tetë ditë pas afatit, prandaj PZAP-i në mbështetje të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në mbështetje të nenit 118.1 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja**

Anr. 849/2013 më datën 13.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Nenad Lazić**



***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.